

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7118
E enjte, 15 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Kuvendi voton Remzie Zeqirajn komisionare parlamentare për FSK-në



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NDIHMËSSEKRETARI AMERIKAN I SHTETIT, JAMES O'BRIEN,
KA FOLUR PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË KOSOVË

O'BRIEN THOTË SE QEVERIA E KOSOVËS PO VË NË PIKËPYETJE PARTNERITETIN ME SHBA-në



Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, thotë se Shtetet e Bashkuara janë shumë të shqetësuara me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar përdorimin e dinarit. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës po

vë në pikëpyetje partneritetin me ShBA-në. Zyrtari amerikan tha se kishte pasur disa kontakte me kryeministrin Kurti para shpalljes së vendimit dhe vetëm një shkëmbim të shkurtër pas shpalljes së tij. "Ai kuptoi

shqetësimet, premtoi se do të punonte për to, por qartazi vendosi miratimin e vendimit. Nëse ai nuk na trajton si partner, kjo ngre pikëpyetje nëse ne mund ta konsiderojmë këtë qeveri si partnere", ka theksuar O'Brien

AKTUALE



STOLTENBERGU: NATO-ja DO TA MBROJË SECILIN VEND ANËTAR F. 2

BIDENI E INKURAJON VUÇIQIN TË BËJË EDHE KOMPROMISE ME KOSOVËN F. 5

NJOHËSI I ÇËSHTJEVE TË EMERGJENCEVE CIVILE: NUK DUHET TË PËRJASHTOHET RREZIKU NGA ORTEKËT E BORËS F. 6

EKONOMI



ATK-ja GRUMBULLON RRETH 90 % MË SHUMË TË HYRA TATIMORE NË JANAR 2024 KRAHASUAR ME JANARIN E 2019-s F. 8

DOGANA THOTË SE PËR DËRGESAT E SERBISË ME DINARË PO ZBATON VENDIMIN E BQK-së F. 8

SPORT



PRISHTINA, LIRIA DHE TRAJNERI ARMEND DALLKU PËRFUNDONJË NË DISIPLINORË F. 10

KURTI: 14 SHKURTI, MOMENTI I PËRMBYSJES MË TË MADHE POLITIKE DHE DEMOKRATIKE NË KOSOVËN E PASLUFTËS F. 3



VIZITA E BLINKENIT, ME FOKUS NË TË ARDHMEN E SHOIPËRISË DHE BALLKANIT F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Stoltenbergu: NATO-ja do ta mbrojë secilin vend anëtar

BRUKSEL, 14 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se Rusia nuk duhet të ketë asnjë dyshim rreth gatishmërisë së aleancës për ta mbrojtur secilin shtet anëtar të saj. Këtë deklaratë shefi i NATO-s e bëri në prag të nisjes së takimit të ministrave të Mbrojtjes së shteteve të NATO-s, që mbahet më 14 shkurt. Në këtë takim do të diskutohet për situatën në Ukrainë, për fuqinë e aleancës dhe përgatitjet për samitin e Uashingtonit në korrik, kur do të shënohet edhe 75-vjetori i themelimit të NATO-s.

Stoltenbergu u pyet nga gazetarët rreth gatishmërisë së NATO-s pas deklaratave të bëra nga ish-presidenti amerikan, Donald Trump, i cili tha se shteti i tij nuk do t'i mbronte aleatët nëse nuk përmbushin obligimet financiare ndaj NATO-s.

"NATO do të vazhdojë të sigurojë që në Moskë të mos ketë asnjë dyshim se do ta mbrojmë secilin shtet anëtar. NATO për 75 vjet ka parandaluar çdo sulm ndaj cilitdo vend anëtar për shkak se

të gjithë e kanë ditur se NATO do ta mbrojë secilin vend anëtar. Baza e NATO-s është parimi se sulmi ndaj një vendi anëtar është sulm ndaj të gjithëve", tha Stoltenbergu.

"Secili sugjerim se nuk do ta mbrojmë njëri-tjetrin rrit rrezikun. Duhet edhe me vepra, por edhe me fjalë të bëjmë të qartë se mbetemi të gatshëm ta mbrojmë secilin anëtar. Prandaj edhe nuk shohim ndonjë rrezik të menjëhershëm për sulme ndaj ndonjë vendi anëtar të NATO-s, sepse të tjerët e dinë se cila do të ishte përgjigjja e NATO-s", shtoi ai. Shefi i NATO-s përmendi shifrat e fundit lidhur me investimet e aleatëve në fushën e mbrojtjes që, sipas tij, dëshmon se ka përparim drejt përmbushjes së obligimit që nga buxhetet nacionale të ndahen së paku 2 për qind e Bruto Prodhimit Vendor.

"Prej kur më 2014 u bë premtimi në nivel të NATO-s për 2 për qind të BPV-së investime në mbrojtje, janë shtuar 600 miliardë euro më shumë në këto shpenzime. Vitin



e kaluar është rritur për 11 për qind investimi në mbrojtje nga vendet evropiane dhe Kanadaja. Këtë vit 18 vende anëtare të NATO-s do ta arrijnë nivelin prej 2-përqindësh", tha ai.

Trumpi, i cili po synon ta marrë nominimin e republikanëve për të garuar sërish për Shtëpinë e

Bardhë, në fundjavë ka rikujtuar një takim me liderë të NATO-s, e ka cituar presidentin e një "shteti të madh", që nuk ia ka përmendur emrin, duke e pyetur atë: "Zotëri, nëse ne nuk paguajmë, dhe sulmohemi nga Rusia, a do të na mbronin?". "I kam thënë: 'Nuk keni paguar? Jeni delikuent?' Ai ka

thënë: 'Po, kështu ka ndodhur'. Jo, nuk do t'ju mbroj juve. Në fakt do t'i inkurajoja ata të bëjnë çfarë të duan. Duhet të paguani", ka deklaruar Trumpi.

Deklaratat e Trumpit kanë nxitur kritika të ashpra nga Shtëpia e Bardhë, Bashkimi Evropian dhe nga NATO-ja.

Koreja e Veriut kryen testime të reja raketore

PHENIAN, 14 SHKURT - Koreja e Veriut ka gjuajtur disa raketa lundruese në det. Ky është testimi i pestë i armëve të tilla që nga janari, sipas ushtrisë jugkoreane, testime që kanë rritur tensionet në rajon. Shtabi i Përgjithshëm i Koresë së Jugut tha se së bashku me ushtrinë amerikane po analizojnë lëshimet e raketave që u detektuan në ujërat në verilindje dhe në lindje të qytetit Vonsan. Ushtria jugkoreane nuk ofroi detaje për numrin e saktë të raketave të lëshuara apo sa gjatë ato fluturuan.

Ende është e paqartë nëse raketat u lëshuan nga toka apo nga deti. "Ushtria jonë ka rritur vëzhgimin dhe vigjilencën dhe po punon ngushtë me partnerët amerikanë, duke monitoruar nga afër sinjalet e aktivitetit të mëtejshëm nga Koreja e Veriut", tha Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë së Koresë së Jugut.

Ekspertët kanë thënë se Koreja e Veriut po rrit presionin ndaj rivalëve në vitin kur Koreja e Jugut



dhe ShBA-ja mbajnë zgjedhje presidenciale, duke tentuar ta detyrojnë Uashingtonin që ta pranojë idenë që Veriu është një fuqi bërthamore dhe të nxjerrë koncesione ekonomike dhe të sigurisë nga ky pozicion. Lideri verikorean Kim Jong Un ka

lëshuar deklaratat luftënxitëse ndaj Koresë së Jugut, përfshirë edhe deklaratën se ai do të heqë dorë nga objektivi për pajtim me këtë shtet dhe duke kërcënuar se do ta asgjësojë Jugun me armë bërthamore nëse e provokon Veriun.

Ndryshe, raketat lundruese janë të dizajnuara që të manovrohen më lehtë në fluturime sikurse ato me avionë të vegjël. Këto raketa janë në mesin e një numri në rritje të armëve që po zhvillon Veriu, së bashku me raketat balistike që janë të dizajnuara të

lëshohen nga toka dhe deti. Testimi i së mërkurës është i gjashtë gjatë këtij viti i Veriut, nëse përfshihet edhe testimi i 14 janarit, kur Peniani testoi raketën e parë me rreze të mesme veprimi, që operon me karburante të ngurta. Këto testime shfaqin përpjekjet e këtij shteti për t'i avancuar armatimet e tij, me qëllim që armët të arrijnë t'i shënjestrojnë caqet amerikane në Paqësor, përfshirë edhe qendrën ushtarake në Guam. Koreja e Veriut më herët gjatë vitit ka testuar edhe raketa lundruese që lëshohen nga nëndetëset dhe raketa lundruese me rreze të gjatë veprimi, që potencialisht mund të arrijnë bazat ushtarake amerikane në Japoni.

ShBA-ja, Koreja e Jugut dhe Japonia kanë shpeshuar stërvitjet e përbashkëta ushtarake dhe po forcojnë strategjitë e tyre të parandalimit bërthamor.

Rusia synon të largohet nga OSBE-ja

MOSKË, 14 SHKURT - Parlamenti rus do të votojë më 21 shkurt për pezullimin e pjesëmarrjes së shtetit në Asamblesë Parlamentare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), tha kreu i Dumës ruse, Vyacheslav Volodin. OSBE-ja, që ka 57 anëtarë,

përfshirë Ukrainën, Shtetet e Bashkuara dhe Rusinë, është pasardhëse e një organizate gjatë epokës së Luftës së Ftohtë, ku angazhoheshin fuqitë perëndimore dhe sovjetike. Që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, OSBE-ja gjerësisht

është paralizuar nga përdorimi i vetos nga Rusia. "Është koha t'i themi lamtumirë Asamblesë Parlamentare të OSBE-së", tha Volodin gjatë një takimi në Dumë, dhomën e ulët të Parlamentit rus, sipas njoftimit në uebfaqen e Dumës.



Kurti: 14 shkurti, momenti i përmbyesjes më të madhe politike dhe demokratike në Kosovën e pasluftës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 SHKURT - Në mbledhjen e 188 të Qeverisë së Kosovës, kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se në tri vitet e fundit ekonomia ka shënuar rritje të vazhdueshme, është qeverisur me duar të pastra dhe është treguar guxim dhe vendosmëri në zbatimin e ligjit. Ai ka thënë se zhvillimi ekonomik është duke ndodhur dhe do të vazhdojë. “Me punë të ndershme ngritëm të hyrat tatimore, ngritëm prodhimin, eksportet dhe investimet e jashtme në shifra të papara ndonjëherë më parë. Në tri vitet e fundit ekonomia jonë ka shënuar rritje të vazhdueshme: me një mesatare vjetore prej 6.2-përqindësh të bruto produktit vendor. Janë dyfishuar investimet e huaja direkte dhe eksportet, si dhe ka pasur një rritje prej dy të tretave të të ardhurave nga taksat pa ndryshime thelbësore të politikës fiskale”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se: “Pasi ndalëm gjakderdhjen financiare, me masat tona qeveritare kemi rishpërndarë te qytetarët edhe rritjen ekonomike, edhe rritjen e të hyrave të shtetit. Arsimin e lartë e bëmë falas, siç kishim

premtuar. Filluam me shtesa për nënat lehona dhe fëmijë, siç kishim premtuar. Krijuam platformën dhe mbështetëm punësimin e të rinjve, siç kishim premtuar. Luftuam krimin dhe korrupsionin, siç kishim premtuar. Shkatërruam bandat kriminale në vend, përfshi ato të drogës e të kriptovalutave”, është shprehur kryeministri. Në trevjetorin e fitores së IV-së më 2021, Kurti ka thënë se shtetit ia kthyen terminalët doganore siç kishin premtuar. “E ndërmarrjet publike i kthyem në ndërmarrje fitimprurëse nëpërmjet investimeve të qeverisë që po vazhdojnë. Për të rinjtë, krahas bursave, trajnimeve të ndryshme, granteve, aplikuar edhe platformën e suksesshme të punësimit ‘Superpuna’. Tashmë i kemi zgjeruar mundësitë për punësimin e të rinjve nga mosha 18 deri në 29 vjeç. Për 11 muaj ‘Superpuna’ ka ndërmjetësuar punësimin e 9 400 të rejave dhe të rinjve”, ka theksuar ai, duke shtuar se mbështetja për bizneset e reja e të vogla, fermerët dhe organizatat joqeveritare, si dhe punësimi i komuniteteve joshumicë, kurrë nuk e ka pasur fokusin qeveritar dhe dobinë për qytetarët sikurse në këto tri vite. “Kosova është e të gjithëve, dhe të gjithë duhet të kontribuojnë për

të. Sundimi i ligjit dhe shpërndarja e mirëqenies na bashkojnë, pa dallim etnik”, ka thënë ai. Kurti ka thënë se 14 shkurti nuk paraqet vetëm përvjetorin e një fitore elektorale por, sipas tij, 14 shkurti është momenti i përmbyesjes më të madhe politike dhe demokratike në Kosovën e pasluftës. “Është revolucioni elektorale, ku ngadhënjeu mirëqeverisja mbi korrupsionin, drejtësia mbi diskriminimin dhe interesi i përbashkët e publik mbi atë personal dhe privat. Për këto tri vjet dëshmuam se është e mundur të qeveriset në përputhje me vullnetin e popullit, me duar të pastra, duke ruajtur e mbrojtur vendin, kushtetutshmërinë e ligjshmërinë dhe paqen e sigurinë”, ka deklaruar Kurti. Ai ka theksuar se vendi ynë gjatë këtyre tri viteve ka qenë shembull i vërtetë i guximit e vendosmërisë së popullit dhe i qeverisë së tij, në përballje me sfida të mëdha, që erdhën e kaluan njëra pas tjetrës. “Ne betejmë me pandemi siguroam vaksinat për një kohë shumë të shkurtër. Në përballje me pasojat ekonomike dhe energjetike të pandemisë dhe të agresioni ushtarak të Rusisë në Ukrainë, përgatitëm Pakon mbështetëse për qytetarët dhe

bizneset. Banka Botërore vlerësoi se Kosova kishte pakon fiskale më të madhe në rajon, që u doli në ndihmë drejtpërdrejt qytetarëve, familjeve dhe bizneseve në përballje me sfidat globale të energjisë dhe kostos së jetesës të reflektuara edhe te ne. Janë përpjekur ta vonojnë reformën tonë në ekonomi dhe drejtësi, duke i sfiduar nismat tona në Gjykatën Kushtetuese, por reformat do të bëhen e po bëhen. Ligjshmëria dita-ditës po shtrihet në çdo cep të Republikës së Kosovës, siç kishim premtuar”, ka thënë Kurti. Kryeministri ka thënë se qeveria në këto tri vjet ka investuar më shumë se të gjitha qeveritë e kaluara marrë së bashku në Forcat e Sigurisë së Kosovës, duke e bërë FSK-në një forcë serioze në mbrojtjen e paqes dhe sigurisë në vendin tonë. “Gjersa në vitet 2018-2020 ishin investuar 3.6 milionë euro në pajisje, ne nga fillimi i qeverisjes sonë i kemi investuar 239 milionë euro në pajisje të reja, të teknologjisë së fundit”, ka treguar ai. Duke folur për lidhjen e arsimit me tregun e punës, Kurti ka bërë me dije se filluan zbatimin e arsimit dual tashmë në 21 shkolla, në 14 komuna, gjithandej Kosovës, në gjithsej 12 profile deri më tani. “Ndërkaq,

arsimin e lartë e bëmë falas. Prodhimtarinë vendore, bujqësinë e bujkun në veçanti i mbështetëm si asnjëherë më parë. Objektet shëndetësore i rinovuam, shkurtuam listat e pritjes, ndërkaq numrin e rasteve për trajtim jashtë vendit në shëndetësi e reduktuam ndjeshëm. Avancuam politikën e jashtme. Liberalizimi i vizave u jetësua sivjet. E realizuam, ndonëse nuk e kishim premtuar. Spanja njohu pasaportat tona, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Izraeli, hoqën vizat për qytetarët tanë”, ka deklaruar ai. Kryeministri Kurti ka thënë se 14 shkurti është vullneti i këtij populli për të ndërtuar të ardhmen e tij në mes të popujve e shteteve të tjera të barabarta, të zhvilluara, demokratike e të forta. “Kosova e 14 shkurtit, sot pas tre vjetësh, është Republikë më e fortë, më e qëndrueshme, më e sigurt dhe më e mirë për të jetuar. Në Republikën e Kosovës më 14 shkurti nuk shënohet thjesht vetëm dita e dashurisë ndaj njerëzve të dashur, por shënohet edhe dita e dashurisë dhe përkushtimit ndaj Republikës sonë. 14 shkurti për Kosovën është dita e dashurisë ndaj vlerave dhe interesit të përbashkët”, është shprehur kryeministri Kurti.



NDIHMËSSEKRETARI AMERIKAN I SHTETIT, JAMES O'BRIEN, KA FOLUR PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË KOSOVË

O'Brien thotë se Qeveria e Kosovës po vë në pikëpyetje partneritetin me ShBA-në

Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, thotë se Shtetet e Bashkuara janë shumë të shqetësuara me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar përdorimin e dinarit. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës po vë në pikëpyetje partneritetin me ShBA-në. Zyrtaari amerikan tha se kishte pasur disa kontakte me kryeministrin Kurti para shpalljes së vendimit dhe vetëm një shkëmbim të shkurtër pas shpalljes së tij. "Ai kuptoi shqetësimet, premti se do të punonte për to, por qartazi vendosi miratimin e vendimit. Nëse ai nuk na trajton si partner, kjo ngre pikëpyetje nëse ne mund ta konsiderojmë këtë qeveri si partnere", ka theksuar O'Brien

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, James O'Brien, thotë se Shtetet e Bashkuara janë shumë të shqetësuara me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar përdorimin e dinarit. Në një intervistë për shefin e Shërbimit Shqip të Zërit të Amerikës, O'Brien thotë se me këtë qëndrim

Qeveria e Kosovës ka vënë në pikëpyetje partneritetin me Shtetet e Bashkuara. "Unë nuk bëj kërcënime të vagëta në publik. Unë do të thosha, që nëse ne nuk trajtohem si partner, edhe ne nuk do ta trajtojmë Qeverinë e Kosovës si partnere", ka thënë ai. Kosova duhet të tërhiqet nga vendimi për dinarin, thotë zyrtaari

i lartë amerikan. Ndonëse Shtetet e Bashkuara e kishin këshilluar Qeverinë e Kosovës kundër një veprimi të tillë, ajo vendosi ta zbatojë atë, pa konsideruar këshillat e partnerëve kryesorë, thotë O'Brien. Vendet moderne të Evropës, thotë O'Brien, i zgjidhin këto

çështje me dialog paraprak dhe i informojnë banorët me kohë. Zyrtaari amerikan tha se kishte pasur disa kontakte me kryeministrin Kurti para shpalljes së vendimit dhe vetëm një shkëmbim të shkurtër pas shpalljes së tij. Dhe si e priti ai vlerësimin tuaj? "Ai kuptoi shqetësimet, premti se do të punonte për to, por qartazi vendosi miratimin e vendimit. Nëse ai nuk na trajton si partner, kjo ngre pikëpyetje nëse ne mund ta konsiderojmë këtë qeveri si partnere", është përgjigjur në këtë pyetje O'Brien. Ai ka theksuar se kjo është çështje partneriteti dhe aftësie në qeverisje. "Të gjitha problemet që janë hasur që kur u shpall ky

vendim, u identifikuan që në 5-10 minutat e para, pasi mësuam për të. Megjithatë qeveria vazhdoi zbatimin e tij pa paralajmërim dhe ka lënë një numër qytetarësh të vet të hutuar se si të paguajnë për bukën, qiranë dhe energjinë elektrike, të cilën disa prej tyre sapo kanë filluar ta paguajnë. Kjo nuk është formë e qeverisjes efektive. Jemi shumë të shqetësuar, pasi kjo tregon paaftësinë e qeverisë për t'u shërbyer qytetarëve të saj, por edhe për partneritetin. Të jesh pjesë e Evropës sot nënkupton t'i zgjidhësh çështjet përmes dialogut me planifikimin efektiv dhe paralajmërim. Ky vendim është shpallur me nxitim, pa paralajmërim dhe pa një

Bideni e inkurajon Vuçiqin të bëjë edhe kompromise me Kosovën

PRISHTINË, 14 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se e inkurajon Serbinë të bëjë hapa përpara, "përfshirë edhe kompromise kur është e nevojshme", me qëllim normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi

Evropian. "Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të punojnë nga afër me ju, me Prishtinën dhe me partnerët tanë nga BE-ja, për të arritur këtë qëllim të rëndësishëm", tha Bideni. Ai i bëri komentet në një mesazh urimi dërguar presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, me rastin e

Ditës së Shtetësisë së Republikës së Serbisë. Bideni tha, po ashtu, se e inkurajon Serbinë të vazhdojë të ecë përpara me promovimin e paqes dhe të stabilitetit në rajon. Kosova dhe Serbia janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve nga viti 2011.



përpjekje për t'i shfrytëzuar mekanizmat ekzistues për të gjetur përgjigje për të gjithë problemet që mund të lindin", ka pohuar ai.

Në pyetjen nëse e shihni çështjen e dinarit të lidhur me Asociacionin, O'Brien ka theksuar se çështja është se çfarë problemi po synon të zgjidhë vendimi i ri. "Është e drejtë e Kosovës të vendosë se çfarë valute po dërgohet në juridiksionin e saj. Asociacioni do ta zgjidhte këtë problem duke qartësuar çështjen e parave që dërgohen dhe qëllimet për të cilat do të përdoren. Ka mënyra të tjera për ta siguruar këtë qartësi, përfshirë përmes dialogut, përmes konsultimeve joformale, ashtu si shtetet moderne u japin përgjigje këtyre çështjeve. Jo duke shpallur vendime në mes të natës pasi partnerët tuaj më të afërt ju thonë se kjo është ide e keqe dhe qeverisje e dobët", ka thënë O'Brien.

I pyetur lidhur me marrëdhëniet Kosovë - Serbi që pas marrëveshjeve të Ohrit, O'Brien tha se zbatimi i tyre i përket secilës palë t'i ndërmarrë veprimet e veta, e pakushtëzuar nga pala tjetër.

Serbia, tha ai, ka marrë dy hapa të rëndësishëm drejt njohjes de-

fakto të Kosovës, si çështja e targave dhe dokumentet doganore.

I pyetur nëse Beogradi qëndron prapa sulmit të grupit të armatosur serb në Banjskë, O'Brien tha se Serbia zëvendësoi shefin e shërbimit të zbulimit, i cili ishte i përfshirë në të, tërhoqi trupat afër kufirit me Kosovën dhe se Uashingtoni pret që Serbia t'i ndjekë penalisht personat përgjegjës. "Në pranverën e kaluar, në Ohër, dy palët janë pajtuar për një sërë veprimesh që duhet t'i ndërmarrin njëra pas tjetrës, secila pavarësisht prej veprimeve të palës tjetrës. Dhe tani janë krijuar rrethana që i lejojnë të dyja palët ta fajësojnë njëra-tjetrën në vend se të punojnë që banorët e tyre të jenë të lirë dhe më të përparuar. Dua të theksoj se qysh nga tetori Serbia ka bërë dy hapa të rëndësishëm të normalizimit apo të njohjes de facto të Kosovës, përmes zbatimit të targave të makinave dhe dokumenteve doganore. Këto janë synime që janë kërkuar për një kohë të gjatë dhe u realizuan dhe besoj se ka gjëra të tjera që do të ndodhin në këtë aspekt, nëse i kthehemi dialogut në vend që të veprojmë jashtë tij, siç vendosi të bëjë qeveria (e Kosovës)", është shprehur zyrtari i lartë amerikan.

Kurti reagon pas deklaratës së O'Brient: Marrëdhëniet me ShBA-në nuk janë duke u rrezikuar

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka komentuar qëndrimin e ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, i cili ka thënë se "nëse ne nuk trajtohemi si partner, edhe ne nuk do ta trajtojmë Qeverinë e Kosovës si partnere".

Për këtë deklaratë Kurti ka thënë se marrëdhëniet me ShBA-në nuk janë duke u rrezikuar. Ai ka thënë se Kosova nuk ka partner dhe aleat sikurse Amerika. "Republika e Kosovës nuk ka partner-aleat edhe mik sikurse ShBA-ja. Kështu e konsideroj dhe bashkëpunoj si kryeministër i Kosovës. Banka Qendrore e

Kosovës ka prezantuar një plan 10-pikësh për zbatimin e rregullores së saj. Ne jemi një republikë demokratike. Qeveria nuk u mbivendoset institucioneve të pavarura siç është BQK-ja. Në mesin e këtyre 10 pikave si plan pune për zbatimin e rregullores BQK nuk ka paraparë asnjë masë ndëshkuese, pra pa ndëshkim dhe pa incidente duam të ecim përpara. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria janë prioritetet tona, por njëkohësisht ne kujdesemi edhe për paqe e siguri, kujdesemi edhe për mirëqenien e qytetarëve

serbë", ka thënë Kurti në një deklaratë për medie në Prizren.

Kurti ka falënderuar Amerikën për ndihmën e dhënë gjatë 25 viteve për Kosovën. "Nuk besoj se qytetarët serbë këtë e shohin si problem, por Beogradi zyrtar që nuk na e pranon as pavarësinë e as krimet e kryera para 25 vjetëve, është ai që sjell këso alarmimesh para apokaliptike. Si për BQK-në, si për shtetndërtimin tonë demokratik, si për sistemin tonë financiar, ne i jemi falënderues ShBA-së që ka kontribuar përgjatë këtyre 25 vjetëve të Kosovës së çliruar", është shprehur Kurti.

Duke folur për rastin e Banjskës, ai u ka bërë thirrje të dy qeverive të jenë transparente dhe të hapura me KFOR-in. "Dua të theksoj se Serbia zëvendësoi shefin e shërbimit të zbulimit, i cili ishte i përfshirë në të. Ata kanë arrestuar dhe janë pajtuar se do t'i ndjekin penalisht njerëzit që janë

drejtëpërdrejt përgjegjës për incidentin në Banjskë dhe trupat serbe janë tërhequr nga pjesa afër kufirit. Të gjithë këto hapa janë bërë dhe pastaj, pas Banjskës u ndërmorën hapa drejt njohjes de facto me doganën dhe targat. Këta janë hapa të rëndësishëm që erdhën si rezultat i përgjigjes dhe

përkushtimit ndaj dialogut. Pra, ne duam përkushtim për të punuar drejt zgjidhjes praktike të këtyre problemeve, jo ndërmarrjes së masave të njëanshme për përfitime vetjake që shqetësojnë partnerët tuaj po aq sa shqetësojnë qytetarët tuaj", është shprehur O'Brien.



Profesori në "Johns Hopkins": Veprimet e Kurtit bëjnë që të gjithë ta harrojnë Banjskën

PRISHTINË, 14 SHKURT - David Kanin, profesor i Studimeve Evropiane në Universitetin "Johns Hopkins" në ShBA, thotë se veprimet e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, po "e ndihmojnë Serbinë" dhe "po bëjnë që të gjithë ta harrojnë Banjskën".

Kanin i referohet vendimit që e ndalon përdorimin e dinarit serb në Kosovë, si dhe atij për vendosjen e kryetarëve shqiptarë në komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës. "Amerikanët nuk duan që Kurti të bëjë gjëra që nxisin bela në një rajon, që

Perëndimi e do vërtet të qetë, derisa merret me gjithçka tjetër që po ndodh në botë", thotë Kanin në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Një ditë më herët ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, tha se Qeveria e Kosovës po

rrezikon partneritetin me Shtetet e Bashkuara me vendimin e saj për të mos lejuar përdorimin e dinarit serb.

Kanin thotë se kjo "do të thoshte shumë, pasi ShBA-ja është mbrojtëse e Kosovës". Ai nuk e përjashton mundësinë e sanksioneve,

por thekson se ShBA-ja "nuk do të shkojë aq larg dhe, thjesht, ta ndërpresë marrëdhënien me Kosovën". Kanin thotë se Kosova do të duhej ta shtynte sa më shumë që është e mundur zbatimin e vendimit për dinarin, ose ta revokonte tërësisht.

1.2 milion euro investime për ujin në Kamenicë

KAMENICË, 14 SHKURT - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me kryeshefin e KRU "Hidromorava", Ymer Salihu, kanë nënshkruar marrëveshjen për investimet e reja që do të bëhen në furnizimin me ujë si dhe rregullimet që do të bëhen në sistem. Rogana, Novosella, Hodonoci, Muçiverci, Shipashnica e Dajkoci janë fshatrat e

komunës së Kamenicës të cilat do të kyçen në ujësjellës, problem ky i kamotshëm në këto lokalitete. Vetëm ky investim, sipas njoftimit të kryetarit Rahimaj, arrin vlerën e 303 000 eurosh. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje është përfshirë edhe rregullimi si dhe shtimi i sasisë së ujit për qytetin, me rezervuar të ri. Ky rezervuar që do të vendoset në fshatin Berivojcë arrin

vlerën e 120 000 eurosh. Në këtë fushë momentalisht po punohet edhe në implementimin e projektit FLOWS, projekt ky që arrin vlerën e 750 000 eurosh, i cili ka për qëllim zgjerimin e rrjetit të ujit në qytet si dhe eliminimin e gypave të azbestit në lagjen "Iliria". "Së bashku jemi afër ta eliminojmë pothuajse në tërësi problemin e ujit në Kamenicë", ka thënë Rahimaj.



Ai nëpërmjet njoftimit të tij ka falënderuar Ministrinë e Ekonomisë si dhe KRU "Hidromorava" për bashkëpunimin dhe mundësimin e këtyre projekteve.

Komuna e Prizrenit dhe UNDP fillojnë projektin për promovimin e turizmit

PRIZREN, 14 SHKURT - Në përpjekje të përbashkët për promovimin e turizmit dhe zhvillimit të sektorit privat, komuna e Prizrenit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë nënshkruan marrëveshje për të zbatuar një projekt që do të shërbejë për promovimin e turizmit dhe rritjen e zhvillimit ekonomik në qytet. Kjo marrëveshje, e cila shënon fillimin zyrtar të projektit, është nënshkruar nga Nuno Queiros, përfaqësues i përhershëm i UNDP-së dhe Shaqir Totaj, kryetar i komunës së Prizrenit. Me këtë rast, Queiros ka theksuar se qëllimi nuk është thjesht ta rrisin numrin e vizitorëve, por i një rëndësie vendimtare është të sigurojnë që rritja e turizmit reflektohet në përfitime të qarta

për ekonominë vendore dhe sektorin privat. "Duke rigjallëruar modelet tradicionale të biznesit, ne synojmë të ndërtojmë një themel ekonomik të qëndrueshëm që mund të përshtatet dhe të lulëzojë. Ky partneritet i fundit plotëson bashkëpunimin që daton më shumë se 10 vjet në mes të UNDP-së dhe komunës së Prizrenit dhe është një testament për atë që ne mund të arrijmë së bashku. Unë besoj fuqimisht se së bashku do ta nxisim potencialin e plotë të Prizrenit si destinacion kryesor për turizëm të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik", ka deklaruar Queiros. Dërkaq kryetari Totaj vuri në pah rëndësinë e projektit. "Zhvillimi i turizmit në Prizren është një mundësi e mirë për ta stimuluar ngritjen ekonomike dhe krijimin



e vendeve të punës, duke rritur nivelin e cilësisë së jetesës së banorëve. Investimi në infrastrukturën turistike dhe promovimi i trashëgimisë së pasur kulturore të Prizrenit,

domosdo tërheq vizitorë dhe forcon ekonominë lokale. Prioriteti i zhvillimit të turizmit përputhet me aspiratat tona për t'u bërë një destinacion i njohur, duke kontribuar në zhvillimin

rajonal dhe njohjen ndërkombëtare të Prizrenit", ka thënë Totaj. Projekti Promovimi i Turizmit dhe Zhvillimi i Sektorit Privat është një iniciativë në kohëzgjatje prej një vit e gjysmë e financuar bashkërisht nga komuna e Prizrenit dhe UNDP-ja. Rezultatet e projektit do të jenë të dyfishta: hartimi dhe zbatimi i një fushate promovuese të turizmit ku do të paraqiten vlerat e pasura kulturore, historike, natyrore dhe praktike të Prizrenit për të tërhequr më shumë vizitorë dhe për ta mbështetur rritjen dhe zhvillimin e sektorit privat përmes rivitalizimit të modeleve tradicionale të biznesit dhe përforcimin e identitetit tregtar që do të lehtësohet nëpërmjet metodologjisë së UNDP-së "In Motion".

Njohësi i çështjeve të emergjencave civile: Nuk duhet të përjashtohet rreziku nga ortekët e borës



PRISHTINË, 14 SHKURT - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave civile, ka reaguar ndaj rasteve me fatalitet që po ndodhin si pasojë e ortekëve të borës në Brezovicë. Një ditë më parë një shtetase e huaj 54-vjeçare ka humbur jetën në Brezovicë si pasojë e rrëshqitjes së borës. "Me datë 13.02.2024, rreth orës 15:35, kemi marrë një informacion se një person dyshohet se ka mbetur i vdekur gjatë skijimit në Qendrën e Skijimit

në Brezovicë, në vendin e quajtur 'Foleja e Shqiponjës'. Dyshohet se shkak i këtij incidenti ka qenë rrëshqitja e një orteku të borës. Ekipet e policisë dhe ekipet të kërkim shpëtimit janë atje dhe për informata tjera do t'ju njoftojmë me kohë. Viktima është femër, shtetase e huaj, e moshës rreth 54 vjeçare", është theksuar në njoftimin e policisë. Ahmeti ka theksuar se rreziku nga ortekët e borës nuk duhet të përjashtohet. "Është potencuar

disa herë se Kosova nuk bën pjesë në zona të rrezikshmërisë së ortekëve, mirëpo praktikat po e dëshmojnë të kundërtën. Deri më tani kemi disa raste me fatalitet nga ortekët e borës andaj, përveç tri rreziqeve natyrore nga të cilat kryesisht rrezikohet Kosova, tërmete, vërshimeve dhe zjarreve pyjore, as rreziku nga ortekët e borës nuk duhet të përjashtohet dhe injorohet", ka thënë njohësi i çështjeve të emergjencave civile, Tahir Ahmeti.

Komuna e Drenasit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me "Islamic Relief"

DRENAS, 14 SHKURT - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë për Bujqësi, Anita Avdullahu - Dvorani, kanë pritur në takim përfaqësuesit e organizatës "Islamic Relief Kosova", përkatësisht Mohamed Soliman, ku edhe kanë nënshkruar memorandumin e

bashkëpunimit për realizimin e projekteve bujqësore për fermerët e komunës së Drenasit. Me nënshkrimin e memorandumit, komuna e Drenasit së bashku me organizatën "Islamic Relief Kosova" do të bashkëfinancojnë katër projekte bujqësore ku përfshihen: motokultivatorë

për fermerë, sera, shpërndarëse plehu artificial si dhe spërkatëse. Lladrovci ka falënderuar drejtorin e "Islamic Relief Kosova", Soliman dhe këtë organizatë, që për sa vite është mbështetëse e shumë projekteve bujqësore për fermerët e komunës së Drenasit.



Vizita e Blinkenit, me fokus në të ardhmen e Shqipërisë dhe Ballkanit

PRISHTINË, 14 SHKURT - Vizita njëditore e kryediplomatit amerikan në Shqipëri, Antony Blinken, në Shqipëri, do të përqendrohet në të ardhmen e këtij shteti dhe të Ballkanit Perëndimor. Kështu tha zëvendësndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Evropë dhe Euroazinë, Yuri Kim, e cila dha detaje për vizitën e parë të sekretarit amerikan të Shtetit në Shqipëri, që do të zhvillohet të enjten më 15 shkurt.

Kim tha se vizita përkon me fillimin e shekullit të dytë të raporteve ShBA - Shqipëri. "Ne duam ta vëmë në pah bashkëpunimin e mirë që kemi me Shqipërinë. Ne duam t'i falënderojmë ata që kanë qenë nikoqirët kryesorë për afganët në nevojë dhe për vazhdimin e traditës shqiptare për t'i strehuar ata që janë në rrezik", tha Kim, duke i referuar pranimit të afër 2 400

afganëve që ikën nga shteti i tyre pas rikthimit të talibanëve në pushtet verën e vitit 2021.

Blinken do të takohet me Ramën dhe presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj.

Ai, po ashtu, do të takohet me një grup të rinjsh që kanë qenë përfitues të bursave amerikane për shkollim.

Vizita e Blinkenit në Shqipëri është në kuadër të një udhëtimi dyditor, që përfshin edhe ndalesën në Gjermani, ku ai do të marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë së Muniht, së bashku me nënpresidentin amerikane Kamala Harris, e cila do ta mbajë fjalimin kryesor.

Blinkenu pritet të përqendrohet në mbështetjen e ShBA-së për Ukrainën, që po përballet me pushtimin rus, si dhe për konfliktin në Lindjen e Mesme dhe tensionet e rritura në Ngushticën e Tajvanit.



Krasniqi takon Szunyogin: Qytetarët po vuajnë pasojat e sanksioneve të vendosura nga BE-ja për shkak të paaftësisë së qeverisë Kurti



PRISHTINË, 14 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të mërkurën në takim shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet aktuale politike në vend dhe për perspektivën evropiane të Kosovës. "Ambasadorit Szunyog

ia ritheksova se qytetarët e Kosovës po vuajnë pasojat e sanksioneve të vendosura nga Bashkimi Evropian për shkak të papërgjegjësisë dhe paaftësisë së qeverisë Kurti, e cila po vazhdon të marrë vendime të pamatura dhe po tenton ta cenojë pavarësinë e institucioneve më të larta

juridike dhe ekonomike në vend", ka thënë Krasniqi pas takimit, duke shtuar se PDK-ja si parti shtetformuese dhe shtetndërtuese, dhe si lidere e opozitës, do të vazhdojë të luajë rol konstruktiv në mirëmbajtjen dhe avancimin e raporteve të mira me aleatët ndërkombëtarë të Kosovës.

Kuvendi voton Remzie Zeqirajn komisionare parlamentare për FSK-në

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur komisionare parlamentare për Forcën e Sigurisë së Kosovës Remzie Zeqirajn. Pas dy raundeve të votimit, ajo ka marrë 49 vota, ndërkaq Fadil Hadergjonaj 43 vota. Mandati i komisionares parlamentare është pesëvjeçar. Kryetari i Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Bekë Berisha, ka njoftuar për kandidatët e propozuar nga komisioni funksional. "Komisioni Funksional për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në pajtim me dispozitat e Ligjit numër 08L133, ka zhvilluar procedurat për zgjedhjen e komisionarit

parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe në përfundim, dhe sipas rezultatit vlerësues, tre kandidatët më të suksesshëm për votim në seancën e kuvendit janë si në vijim: Sami Hajrullahu, 89 pikë, Fadil Hadergjonaj, 88 pikë, Remzie Zeqiraj, 85 pikë", ka thënë ai.

Deputetja Albana Bytyqi ka paraqitur numrin e votave për secilin kandidat për komision parlamentar të FSK-së. "Në votim kanë marrë pjesë 96 deputetë, të pavlefshme janë katër fletëvotime. Kandidatja Remzie Zeqiraj ka marrë 49 vota, ndërsa Fadil Hadergjonaj 43 vota", ka njoftuar ajo.



Përurohet libri i ish-presidentit Sejdiu, "Ora e Kosovës - pavarësia dhe shtetndërtimi"

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka promovuar librin "Ora e Kosovës - pavarësia dhe shtetndërtimi". Një libër i cili trajton angazhimin e ish-presidentit Sejdiu në etapa të ndryshme historike si dhe rrugëtimin e Kosovës që nga kohët e vështira në përpjekjet

për liri si dhe gjatë fazës së shtetndërtimit.

Në promovimin e këtij libri morën pjesë personalitete të shquara kombëtare e ndërkombëtare. "Dokumentimi i këtyre ngjarjeve historike do t'u shërbejë brezave të ardhshëm për informimin dhe vetëdijesimin për rolin e shumë

gjeneratave që kanë dhënë kontribut të madh për çështjen kombëtare deri në arritjen e pavarësisë si kurorë e rrugëtimin historik të popullit të Kosovës", ka thënë ish-kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ishte pjesëmarrës në promovimin e këtij libri.



Dogana thotë se për dërgesat e Serbisë me dinarë po zbaton vendimin e BQK-së

PRISHTINË, 14 SHKURT - Serbia tha se Kosova ka ndaluar edhe një dërgesë me dinarë në Kosovë, por nga Dogana e Kosovës thanë se disa persona, që janë paraqitur se përfaqësojnë një bankë tashmë të mbyllur, janë udhëzuar që ta ndjekin vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës për paratë e gatshme. “Në pikëkalimin kufitar të Jarinjës janë paraqitur disa persona që pretendojnë se përfaqësojnë Bankën Komercijalë, e cila tashmë është mbyllur. Këta persona janë interesuar për procedurën e lëvizjes së parave të gatshme. Të njëjtët janë udhëzuar që t’i ndjekin njoftimet e BQK-së derisa Dogana e Kosovës, po ashtu, zbaton normat e njëjta ligjore”, tha për “Radion Evropa e Lirë” zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci.

Banka NLB Komercijalë deri në fund të këtij janari kishte operuar në Kosovë dhe kishin licencë që të punonin me dinarin serb në Kosovë. Banka ka njoftuar klientët e saj se llogaritë e tyre në dinarë do të transferohen në një nga degët e bankës në qytetet e Serbisë. Që nga 1 shkurti në Kosovë është në fuqi një rregullore e Bankës

Qendrore të Kosovës, e cila thotë se vetëm euroja është valuta për pagesa me para të gatshme, duke ndaluar përdorimin e dinarit serb. Zyra për Kosovën në qeverinë serbe tha se dinarët që u ndalën të shkonin në Kosovë ishin të destinuara për pagesën e rrogave, pensione dhe ndihmës tjetër sociale për pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë.

Shefi i kësaj zyre, Petar Petkoviç, tha se përfaqësuesit e Bankës Popullore të Serbisë dhe kompanisë “Henderson” janë përzënë nga pika kufitare mes Kosovës dhe Serbisë në Jarinjë. Ai pretendoi se Policia e Kosovës i ka kërcënuar ata me arrestim. “Kështu, [kryeministri i Kosovës, Albin Kurti] e ka thënë qartë se e ashtuqajtura periudhë tranzitore është gjenjeshërë dhe se po punohet gjatë gjithë kohës në funksionalizimin për ndalimin e dinarit”, u tha në reagim.

Petkoviç i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare që “ta rrisë edhe më shumë presionin ndaj Prishtinës për të hequr dorë përfundimisht nga vendimi i njëanshëm për ndalimin e dinarit”.

Më 7 shkurt autoritetet serbe, po



ashtu, kishin deklaruar se një dërgesë me dinarë serbë u ndal në Jarinjë, por nga Dogana e Kosovës kishin argumentuar se palës serbe i ishte sqaruar se qarkullimi i mjeteve nuk lejohet pa autorizimin e Bankës Qendrore të Kosovës.

Po atë ditë zëvendëskryeministri i

Kosovës, Besnik Bislimi, deklaroi se Banka Popullore e Serbisë, dërgoi një kamion mbushur me dinarë serbë në vlerë prej afër 1 milion eurosh drejt kufirit të Kosovës. Por, sipas tij, individët që po e përcillnin këtë mjet transportues, “u prezantuan me kredenciale të një kompanie

inegzistente me pretendimin që paratë duan t’i dërgojnë te një entitet po ashtu inekzistent në Kosovë dhe për interes të përfituesve, emrat e të cilëve as i dinë, as nuk i kanë”.

Në rregulloren për operacione me para të gatshme, të miratuar nga BQK-ja, thuhet se institucionet e licencuara për operim në Kosovë mund ta kryejnë importin dhe eksportin e valutave. Dogana dhe Policia e Kosovës janë autoritetet përgjegjëse që sigurohen që importi apo eksporti ndërkufitar i euros apo valutave të tjera nga dhe për në Kosovë mund të lejohet vetëm “përmes paraqitjes së dëshmisë së licencës dhe autorizimit të lëshuar nga BQK-ja”. Serbia ua paguan serbëve të Kosovës - përmes një sistemi paralel - pagat, pensionet, ndihmat sociale dhe përfitimet e tjera.

Komuniteti ndërkombëtar po i kërkon Kosovës ta shtyjë zbatimin e këtij vendimi, duke argumentuar se ai është marrë pa konsultime paraprake dhe pa informimin e duhur të qytetarëve. BQK-ja në fillim të javës bëri me dije se rregullorja do të zbatohet përmes një faze tranzitore jo më të gjatë se tre muaj.

Vendimi përfundimtar për shpronësimin e pronave për rrugën Kijevë - Zahaq, rruga 12.8 km do të kushtojë 32 milionë euro



PRISHTINË, 14 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën vendimin përfundimtar për shpronësim të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit që preken nga realizimi i projektit për rrugën nacionale Kijevë - Zahaq, konkretisht në segmentin Kijevë - Dollc.

Lidhur me shpronësimin e pronave në këtë segment ka folur ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu. “Për shpronësimin e pronave që janë prekur nga realizimi i projektit pas plotësimit të kushteve nga Ligji për shpronësim propozojmë që të nxirret vendim me të cilën

miratohet vendimi përfundimtar për shpronësimin e pronave të paluajtshme të pronave dhe zotëruesve të interesit që preken nga ky projekt i rëndësishëm”, ka thënë ai.

Pas miratimit në qeveri, lidhur me këtë vendim ministri Aliu ka shkruar edhe në “Facebook”. “Në mbledhjen e sotshme të qeverisë, të 188-n me radhë, miratuar vendimet për shpronësimin e pronave të paluajtshme për realizimin e Rrugës Nacionale N9 Kijevë-Zahaq, segmenti Kijevë-Dollc. Këto njëherësh janë vendimet përfundimtare për shpronësimin e pronave të paluajtshme (tokave) të pronarëve dhe të palëve të

interesit, të cilët preken nga realizimi i këtij projekti, përkitazi Zona Kadastrale: Kijevë, komuna e Malishevës dhe Zonat Kadastrale: Çabiç, Zabërgjë, Gllarevë, Dresnik, Gremnik dhe Dollc të komunës së Klinës”, ka bërë me dije Aliu.

Rruga Nacionale N9 Kijevë-Zahaq, segmenti Kijevë-Dollc, është e ndarë në 4 lote, me gjatësi totale prej 12.8 km dhe me një buxhet të planifikuar prej 32 milionë eurosh. “Jemi të përkushtuar plotësisht për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të rajonit të Dukagjinit”, ka shkruar ministri Aliu.

ATK-ja grumbullon rreth 90 % më shumë të hyra tatimore në janar 2024 krahasuar me janarin e 2019-s

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ministria e Financave ka njoftuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka grumbulluar rreth 90 % më shumë të hyra tatimore në janar 2024 krahasuar me janarin e 2019-s. “Bazuar në krahasimin e të hyrave tatimore dhe numrit të tatimpaguesve për periudhën janar 2019 dhe periudhën janar 2024, i bie që Administrata Tatimore e

Kosovës ka arritur të grumbullojë mbi 52.3 milionë euro më shumë në janarin e vitit 2024, krahasuar me atë të vitit 2019. Rritje e theksuar vërehet edhe te numri i tatimpaguesve, ku nga 37 459 tatimpagues sa ishin në janar të vitit 2019, numri i tatimpaguesve në janar të vitit 2024 është rritur për 10 658, apo 28 %, pra duke arritur numrin prej 48 117

tatimpaguesve. Kjo tregon se ka më shumë biznese aktive që po paguajnë tatim, pra zgjerim i bazës tatimore. Rritja e theksuar në këta dy indikatorë është rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe si rezultat i zbatimit të ligjit dhe rritjes së efikasitetit të Administratës Tatimore të Kosovës në mbledhjen e tatimeve”, ka njoftuar Ministria e Financave.



'The Economist': Europa duhet të përgatitet të mbrohet nga Trump dhe Rusia



"Ftesa" e ish-presidentit amerikan Donald Trump drejtuar Vladimir Putin për të sulmuar aleatët amerikanë që nuk përmbushin detyrimet e tyre financiare ndaj NATO-s është një zhvillim i ri shqetësues në anën tjetër të Atlantikut.

Nëse Donald Trump kthehet në Shtëpinë e Bardhë, në "çfarë versioni do të jetë?". "Ai që i shtyn aleatët të shpenzojnë më shumë për mbrojtjen, vendos trupa të NATO-s në krahun lindor dhe fillon të armatosë Ukrainën apo ai që kërcënon të largohet nga aleanca dhe kritikon Vladimir Putinin?"

Në një tubim të 10 shkurtit, Trump, kandidati i supozuar republikan presidencial, tregoi se si lideri i një "vendi të madh" e pyeti dikur nëse Amerika do të mbronte një aleat që po "vononte" pagesat e tij, me sa duket një aleat që nuk i përmbushi objektivat e NATO-s për të shpenzuar 2% të PBB-së për mbrojtjen.

"Jo, nuk do të të mbroja", u përgjigj Trump në atë kohë.

"Në fakt, unë do t'i inkurajoja ata të bëjnë çfarë të duan. Ju duhet të paguani. Ju duhet të paguani faturat tuaja," tha ai.

Këto fjalë përbëjnë sulmin më të

dëmshëm të Trump ndaj NATO-s dhe duhet të shërbejnë si alarm për të gjithë aleancën. Nuk ka shumë rëndësi nëse ai është duke e ekzagjeruar apo duke ritreguar një bisedë të vjetër.

Nxitja ndaj Rusisë për të sulmuar çdo vend të NATO-s në çfarëdo mënyre dobëson premtimin e shenjtë të Nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut: se një sulm ndaj një aleati është një sulm ndaj të gjithëve dhe se një sulm edhe ndaj aleatit më të vogël është, në fakt, sulm mbi Amerikën.

Trump pretendon se masat shtrënguese të tij kanë arritur të bëjnë aleatët të shpenzojnë miliarda më shumë për mbrojtjen. Në vitin 2017, vitin e tij të parë në detyrë, vetëm katër nga 29 aleatët e NATO-s arritën objektivin prej 2 për qind, sipas shifrave të NATO-s.

Deri në vitin 2020, viti i fundit i presidencës së tij, ky numër ishte rritur në nëntë.

Trump sigurisht që ndihmoi aleatët në presion. Shtysa më e madhe, natyrisht, ishte kërcënimin në rritje nga Rusia: shpenzimet e mbrojtjes filluan të rriteshin në vitin 2015, para epokës së Trump, dhe vazhduan edhe më pas.

Në vitin 2023, me Biden në

pushtet, 11 nga 31 aleatët arritën objektivin e 2% – shumica ka të ngjarë ta arrijë atë këtë vit, raportojnë mediat britanike. Nëse zgjidhet, politikat e mandatit të dytë të Trump do të varen pjesërisht nga këdo të emërojë në poste drejtuese.

Por ndikimi i tij i dëmshëm tashmë ndihet. Kundër gjykimit më të mirë të disa republikanëve, mbështetësit "Amerika së pari" të Trump kanë bllokuar për muaj të tërë miratimin e një projektligji për të rinovuar ndihmën ushtarake dhe civile për Ukrainën. Trump dhe mbështetësit e tij në Kongres mburren se ai parandaloi luftëra të mëdha në kohën e tij, sepse armiq të kishin frikë. Duke folur pas shpërthimit të fundit të Trump, senatori Lindsey Graham tha: "Rusia nuk pushtoi askënd kur ai ishte president".

Parandalimi funksionon kur angazhimi për mbrojtjen kolektive është absolut dhe i qartë. Duke hedhur dyshime, Trump ftoi Rusinë dhe armiq të tjerë të testonin vendosmërinë e Perëndimit.

Ministri i mbrojtjes i Danimarkës paralajmëroi kohët e fundit se Rusia mund të testojë angazhimin e anëtarëve të NATO-s ndaj nenit

5 brenda tre deri në pesë vjet. Homologu i tij britanik tha se vendi duhet të përgatitet për luftërat që përfshijnë Rusinë, Kinën, Iranin ose Korenë e Veriut në pesë vitet e ardhshme. Siç vë në dukje The Economist, europianët duhet të veprojnë urgjentisht për të kundërshtuar një kërcënim të dyfishtë: një sulm nga Rusia dhe braktisje nga Amerika.

Në vend që të ankohen për Trump, ata duhet të fokusohen në arritjen e objektivit prej 2%. Ata gjithashtu duhet të rishikojnë pragun: 3% e PBB-së është ndoshta ajo që nevojitet tani për të përmbushur planet ekzistuese të mbrojtjes së NATO-s dhe duhet të jetë më i lartë pa ndihmën e SHBA-së.

Amerika shpenzoi gati 3.5% të PBB-së për mbrojtje vitin e kaluar. Europianët po përballen me një kërcënim shumë më të madh. Europianët do të duhet të investojnë në çdo gjë, nga municionet e deri te të gjitha gjërat e tjera që ofron Amerika në një shkallë masive: avionë transporti dhe furnizimi, mbrojtje ajrore, sisteme komandimi dhe kontrolli dhe platforma intelligence duke filluar nga

satelitët tek dronët.

Europianët nuk duhet thjesht të shpenzojnë më shumë, por duhet të shpenzojnë më mirë. Ata duhet të blejnë më shumë komponentë së bashku dhe të integrojnë industritë e tyre të mbrojtjes.


Për të nxitur vendet më të prapambetura, ata duhet të bien dakord që asnjë kandidat nga vendet që nuk plotësojnë standardet minimale nuk mund të zënë poste të larta.

Kjo do t'i shërbejë tre qëllimeve. -Do të forcojë aftësinë e europianëve për të ndihmuar Ukrainën dhe për tu mbrojtur kundër Rusisë.

-Do të tregojë se europianët ndajnë barrën dhe se aleanca është një marrëveshje e mirë për Amerikën, dhe më në fund do të krijojë një mbrojtje kundër braktisjes së Trump.


Humbja e fuqisë amerikane do të ishte e pazëvendësueshme. Megjithatë, ato nuk do të kenë alternativë tjetër veçse të riarmatosen. Mënyra më e mirë për të shmangur këtë, dhe për ta zbutur atë nëse një Trump armiqësor vjen në pushtet, është që Europa të përgatitet për të.

Përktheu: abcnews.al



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Prishtina, Liria dhe trajneri Armend Dallku përfundojnë në disiplinore

“Epoka e re”

PRISHTINË, 14 SHKURT - Në fundjavë është zhvilluar java e 19-të në Superligë, e para në sezonin pranveror. Pas përfundimit të kësaj xhiro, Komisioni Disiplinor i shkallës së parë në Federatën e Futbollit të Kosovës ka shqyrtuar procedurat e hapura nga Komisioni i Garave, derisa skuadra e Prishtinës dhe ajo e Lirisë kanë përfunduar në disiplinore, sikurse edhe trajneri i Dukagjinit, Armend Dallku. Sipas njoftimit të FFK-së, FC Prishtina në disiplinore ka përfunduar për shkak se tifozët “Plisat” kanë hedhur mjete piroteknike në fushën e lojës në ndeshjen ndaj Feronikeli 74, kurse kërkohet deklarata shtesë nga përfaqësuesi për siguri i skuadrës së Prishtinës. Ndërkohë skuadra e Lirisë në disiplinore ka përfunduar pasi tifozët e kanë goditur me shkrepës në shpinë gjyqtarin kryesor të ndeshjes. Gjithashtu, kërkohet deklarata shtesë nga përfaqësuesi për siguri i KF Liria.



Ndërsa trajneri Armend Dallku nuk kishte të drejtë të ishte i pranishëm për 2-3 minuta në tunelin e stadiumit në ndeshjen ndaj Malishevës. Po ashtu, është kërkuar deklarata shtesë edhe nga trajneri i skuadrës së Dukagjinit. “Pala e pakënaqur në këto vendime ka të drejtë në ushtrimin e ankesës drejtuar Komisionit Disiplinor të shkallës

së dytë – Komisionit për Ankesa në afatin kohor prej; 8 (tetë) ditësh nga data e sjelljes së këtij vendimi; datë 14.02.2023, respektivisht publikimit në faqen zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës. Ankesa e ushtruar nga ana e palës së ankimuar nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit”, thuhet në vendimin e Komisionit Disiplinor.

Përballje interesante në çerekfinale të Kupës

PRISHTINË, 14 SHKURT - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës, në prani të Komisionit të Garave, administratorit të Superligës dhe përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës.

Fituesja e këtij trofeu në edicionin e kaluar, Prishtina, do të ballafaqohet me skuadrën e Ligës së Parë, Trepçën '89. Ndërkaq, Ballkani do të përballlet me Malishevën. Interesante do të jetë edhe përballja tjetër ndërmjet dy skuadrave elitare, Dukagjinit dhe Dritës, por edhe ajo ndërmjet dy skuadrave pretendente për të hyrë në elitë, Vjosës dhe Suharekës 23. Edhe faza çerekfinale zhvillohet vetëm me një ndeshje. Duetet e kësaj faze zhvillohen më 6 e 7 mars.

Çiftet e çerekfinale:

Malisheva - Ballkani
Suhareka - Vjosa
Prishtina - Trepça 89
Drita - Dukagjini



SHKURT

Më 17 shkurt organizohet Turneu i Boksit “Pavarësia”

Përmes një njoftimi për medie Federata e Boksit e Kosovës (FboxK) ka bërë me dije se do të vazhdojë edhe këtë vit organizimin e Turneut Ndërkombëtar të Boksit “Pavarësia”. FboxK-ja do ta organizojë këtë turne për të 16-n herë me radhë. Pjesëmarrëse të këtij turne, krahas Kosovës, do të jenë edhe shtetet e rajonit si Bullgaria, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Turneu do të zhvillohet më 17 shkurt me fillim nga ora 12:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Peshimi i boksierëve do të bëhet nga ora 08-09. Ndërsa gjyqtarë do të jenë Agim Shala, Agim Tahiraj, Fadil Bektashi, Visar Ibrahim, Granit Qorri, Filip Nue. Delegat do të jetë Sylejman Voca, kurse mjek kujdestar Artan Lushaj.

KB Istogu liron tre basketbollistët amerikanë

KB Istogu pas humbjes nga Trepça (84-51) dhe eliminimit nga Kupa e Kosovës në basketboll ka liruuar tre basketbollistët amerikanë. Fjala është për Ty Prince, Desmond Holloway, Daquan Brooks. “Klubi pas ndeshjes së fundit ka vendosur që ta shkëpusë marrëveshjen dhe t’i lirojë tre lojtarët amerikanë. Klubi i falënderon lojtarët për kontributin dhe pjesën e mbetur të kampionatit do t’ua japë shansin lojtarëve vendorë”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Istogut.

Haxhijaj dhe Gashi do t’i mbrojnë ngjyrat e Kosovës në futsall

Dy talentet e futsallit, Drilon Haxhijaj dhe Jetmir Gashi, do t’i mbrojnë ngjyrat e vendit të tyre të lindjes, Kosovës, në eliminatorët e ardhshme. Kjo u arrit falë punës së madhe të drejtuesve të futsallit kosovar dhe bisedave konstruktive që kishin me lojtarët. Drilon Haxhijaj është 20-vjeçar dhe aktualisht mbron ngjyrat e FC Drenicës. Ai stinorin vjeshtor e ka mbyllur si top shënues i Superligës së Kosovës dhe 10 gola. Haxhijaj shquhet për shpejtësinë e tij dhe qetësinë para portës, ku me këto kualiteti do t’i ndihmojë shumë Përfaqësueses së Kosovës në të ardhmen. Jetmir Gashi në anën tjetër është 23-vjeçar dhe aktualisht luan te FC Vjosa. Sezonin e shkuar ai ishte top-shënuesi i dytë i kampionatit, duke shënuar plot 30 gola. Edhe Gashi njihet për driblim, shpejtësi dhe saktësi para portës, duke e bërë një lojtar shumë të rrezikshëm për ekipet kundërshtarë.

Manaj në formacionin më të mirë të javës në Superligën turke

Rey Manaj po spikat gjithnjë e më shumë në Turqi. Pas spektaklit dhe golave në fushë, ekspertët e futbollit turq e kanë përzgjedhur në formacionin më të mirë të javës. Manaj ishte protagonist edhe në fitoren e fundit të Sivasporit ndaj Rizesporit, pasi me golin e tij i siguroi tri pikë skuadrës. Manaj është kthyer në një titullar të padiskutueshëm te Sivasporit. Sulmues shqiptar është aktivizuar në 24 ndeshje, ndërsa ka shënuar 16 gola, 12 në Superligë dhe 4 në Kupën e Turqisë. Formacionet: Ali Sasi, Meunier, Necip, Davinson, Ben Ouanes, Hajradinovic, Eysseric, Baris, Augusto, Dragus, Manaj.

Konfirmohet orari i ndeshjes miqësore Suedi - Shqipëri

TIRANË, 14 SHKURT - Është konfirmuar tashmë ora e ndeshjes miqësore Suedi - Shqipëri, që do të luhet më 25 mars në transfertën e Stokholmit. Sipas marrëveshjes mes dy federatave, ky takim do të luhet në stadiumin "Friends

Arena" në Stokholm duke nisur nga ora 19:00. Kjo është ndeshja e gjashtë në histori mes këtyre dy përfaqësuesve, ndër të cilat, katër sfida kanë qenë të vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Botëror, ndërsa dy të tjerat ndeshje miqësore.

Ndërkaq, Shqipëria do të zhvillojë edhe një tjetër miqësore gjatë muajit mars, teksa në ditët në vijim Departamenti i Komunikimit në FShF-ja do ta publikojë edhe emrin e kundërshtarit, vendin dhe orën e takimit. Këto dy

ndeshje miqësore janë në kuadër të përgatitjeve të Kombëtares për Evropianin "Gjermani 2024", ku trajneri Silvinjo do ta ketë mundësinë t'i testojë lojtarët dhe ekipin kuqezi pas thujse katër muajsh nga ndeshja e fundit.



Paraqiten Mercedesi dhe McLareni, synohet triumfi në Formula 1



STUTTGART, 14 SHKURT - Pas Ferrarit, që u paraqit një ditë më parë, të mërkurën ka qenë radha e Mercedesit dhe McLarenit t'i zbulojnë njëvendëshet e tyre për vitin 2024. Dy makina që këtë vit synojnë jo vetëm një vend në podium, por edhe të rikthehen te suksesi pas një viti "agjërimit". Është paraqitur edhe Mercedesi, që për herë të fundit do të pilotohet këtë vit nga Lewis Hamiltoni. Ndërsa piloti tjetër i skuadrës gjermane është George Russell, një dyshe që synon të bëjë një paraqitje më të

mirë këtë vit, pas zhgënjimeve të vjetshme, pavarësisht se u rendit e dyta. Makina e re quhet Mercedes W15 dhe drejtuesi i saj Toto Wolff ka thënë: "E dimë që kemi një mal të lartë për të ngjitur, për të qëndruar mes më të mirëve. Zhvillimi i makinës ka pasur ritme të mira dhe shpresojmë të jemi sa më kompetitivë dhe të rikthehemi te suksesi".

Makina e re McLaren quhet MCL38 dhe do ta përdorë motorin Mercedes dhe ashtu si vjet do të pilotohet nga Lando

Norris dhe Oscar Piastrri. Menjëherë pas prezantimit makina ka zbritur në pistën e Silverstones për "filming day", për t'i marrë edhe të dhënat e para. Një makinë nga e cila pritet shumë, duke parë rritjen e ndjeshme që pati në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar. "Presim testet në Bahrein për të parë se ku jemi me rivalët tanë, por kemi objektiva të qarta. Kemi besim se do ta nisim me këmbën e mbarë", ka thënë shefi i McLarenit, Zak Brown.

Bostoni dhe Minnesota komandojnë konferencat përkatëse, fitojnë lakersat dhe Miami

LOS ANXELOS, 14 SHKURT - Fitorja e pestë radhazi për Boston Celticsin, që mbron kreun e renditjes në

Konferencën e Lindjes, pas triumfit me rezultat 118-110 ndaj Brooklynit. Tatum me 41 pikë ishte

më i miri në fushë për miqtë. Fitoi edhe ekipi i lakersve, që mundi me rezultat 125-111 Detroitin dhe qëndron në zonën "play-out". Të gjithë titullarët e ekipit kalifornian realizuan mbi 10 pikë, ku u dalluan Russell me 21 pikë e Davisi me 20. Zhgënjën Milwaukee, që në fushën e tij u mund me rezultat 123-97 nga Miami. Joviqi me 24 pikë e Robinsoni me 23 bënë dallimin për ekipin nga Florida. Minnesota nuk lëshon kreun në Perëndim, duke mundur me rezultat 121-109 Portlandin, ndeshje ku u dallua Edwardsi me 41 pikë.



REZULTATET

Brooklyn - Boston	110-118
Orlando - Oklahoma	113-127
Milwaukee - Miami	97-123
Phoenix - Sacramento	130-125
Portland - Minnesota	109-121
Lakers - Detroit	125-111

Capello 'skanon' Ligën e Kampionëve: Kujdes Interin

Lideri i Serisë A, Interi, do të dalë në fushë të martën e ardhshme ndaj Atletico Madridit, në ndeshjen e parë të 1/8 finale. Objektivi i skuadrës së Simone Inzaghit është

të provojë të kalojë në raundin tjetër. Angazhimi nuk do të jetë i lehtë, por pas finales së vitit të kaluar kundër Manchester Cityt, skuadra e Simone Inzaghit do të

përpiqet të përmirësojë më tej pozicionin e saj në nivel ndërkombëtar. Mbi ndeshjen e 20 shkurtit në "San Siro", Fabio Capello foli për "Sky Sport":

"Mbrojtja zikalitër është shumë e mirë. Fola me disa gazetarë të huaj dhe më pyetën: Çfarë mendon për Interin? Ai është në krye të kampionatit italian, nuk pëson

gola dhe ka luajtur tashmë në një finale të Ligës së Kampionëve? Kjo nënkupton shumë, ndaj ju them të gjithëve: kushtojni vëmendje Interit".

SHKURT

Fernandez: Nuk do të largohem nga Chelsea

Mesfushori i Argjentinës, Enzo Fernandez, ka folur rreth raportimit të medieve se ai dëshiron të largohet nga Chelsea në afatin kalimtar të verës. Ai ka thënë se po ndihet mirë në skuadrën e Chelseat dhe se nuk do të largohet. "Nuk dua të largohem nga Chelsea. Ndihehem mirë këtu me shokët e skuadrës, me trajnerin dhe stafin. Do të vazhdoj të qëndroj këtu sa të duan ata. Nuk e di nga erdhën ato thashetheme, por unë i mohoj totalisht", ka deklaruar Fernandezi.

Ten Hagen e dëshiron Martinezin në 'Old Trafford'

Kapiteni dhe sulmuesi i Interit, Lautaro Martinez, është duke kaluar një formë të jashtëzakonshme. Kjo ka bërë që për shërbimet e tij të tregojë interesim skuadra e njohur angleze Manchester United. "Fichajes" raporton se trajneri Erik ten Hag personalisht ka kërkuar transferimin e sulmuesit argjentinian. Në vitin 2018, 26-vjeçari iu bashkua Interit nga Racing Club. Nga ajo kohë për klubin italian ka regjistruar 194 paraqitje dhe ka shënuar 98 gola.

De Jong mund të largohet nga Barça

Futbollisti holandez Frenkie De Jong mund të largohet këtë verë nga Barcelona, sipas Jijantes. Ish-lojtari i Ajaxit nuk është i kënaqur me kushtet e kontratës së re e që janë më të këqija se kontrata e kaluar. Kësisoj, ai mund të kërkojë një destinacion të ri teksa katalanasit mund ta sjellin në vendin e tij Mario Hermoson e Atletico Madridit.

Ancelotti: Rezultat i mirë, por duhen edhe 90 minuta për kualifikim

Real Madridi e nisi me këmbën e duhur fazën më të nxehtë në Ligën e Kampionëve, ku doli me një fitore minimale nga sfida kundër Leipzigit (0-1). Carlo Ancelotti është shprehur i lumtur për fitoren, por për kualifikim ka thënë se duhet të zhvillohen edhe 90 minuta. "Për ne nuk ishte e lehtë, por këtu kështu është. Ishte një ndeshje e ekuilibruar, por ekipi im qëndroi në lojë gjatë gjithë ndeshjes. Kishte shumë aspekte pozitive nga kjo ndeshje, u mbrojtëm mirë, mund të shënonim edhe më shumë, por dhe mund të na barazonin, kjo është e vërtetë. Lunin zhvilloi një ndeshje të mirë, më të mirën. Ky rezultat është vetëm një avantazh i vogël, askush nuk e mendonte që do ta mbyllnim kualifikimin që në sfidën e parë, ky ishte një rezultat i mirë, por duhen edhe 90 minuta të tjera", ka thënë Ancelotti.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Menaxher i Higjienës Publike – 1 pozitë

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek: Drejtori Operativ

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Menaxhon punët dhe aktivitetet rreth mirëmbajtjes së pastërtisë dhe higjienës publike në qytet;
- Jep urdhëresa për kryerjen në afat dhe kontinuitet të shërbimeve në pastrimin, larjen e rrugëve, hudhjen e kripës dhe eliminimin e borës dhe akullit nga rrugët dhe sipërfaqet e parapara në planprogramin e punës;
- Bashkëpunon me organet përgjegjëse komunale rreth shërbimeve në mirëmbajtjen e higjienës publike dhe kujdeset për dokumentacionin mbi shërbimet e kryera për qëllim të vërtetimit për punët e kryera dhe për faturim;
- Gjatë sezonës dimërore, me kohë ndërmerr masat e nevojshme për sanimin e gjendjes nga kushtet atmosferike dhe në mirëmbajtjen e rrugëve;
- Harton plan-programet nga fushëveprimi i punëve dhe detyrave për të cilat është përgjegjës dhe orarin e punës për personelin në higjienën publike;
- Me kohë bën planin e shfrytëzimit të pushimit vjetor për punëtorët në higjienën publike;
- Është i obliguar që të ndërmarr masa parandaluese dhe denoncime për lëvizjet e paarsyeshme të autocisternave jashtë terrenit të shërbimit, apo në rastet e keqpërdorimeve të mekanizmit teknik nga fushëveprimtaria e procesit të punës në higjienën publike;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Shkathësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga fusha përkatëse; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë Universitare;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale;

Konkursi është publikuar më datë 15 shkurt 2024 dhe mbyllet më datë 29 shkurt 2024.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
- Dy rekomandime (*nëse keni*);
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
- Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SH.A ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema çlani 8. Zakona br. 03/L-212 rada, çlan 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A kuranu izjavljuje:

KONKURS

Naslov pozicije: Menadžer javne higijene – 1 pozicija

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

Naslov supervizora: Izveštaj: Operativnom direktoru

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje zakazane obaveze: neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti: (kratak opis glavnih zadataka)

- Upravlja radovima i aktivnostima oko održavanja čistoće i javne higijene u gradu;
- Obezbeđuje narudžbine za izvođenje termina i nastavak usluga u čišćenju, pranju puteva, slanom belom luku i eliminaciji snega i leda sa puteva i površina predviđenih planom rada;
- Sarađuje sa odgovornim opštinskim organima o uslugama u održavanju javne higijene i vodi računa o dokumentaciji o uslugama koje se vrše u cilju provere urađenih radova i naplate;
- Tokom zimske sezone preduzima neophodne mere za popravlanje situacije od atmosferskih uslova i održavanja puteva;
- Projektuje programe iz delokruga poslova i zadataka za koje su odgovorni i radno vreme za osoblje u javnoj higijeni;
- Vremenom pravi plan korišćenja godišnjeg odsustva za radnike u javnoj higijeni;
- Dužan je da preduzme preventivne mere i denukleabilne izveštaje o nerazumnom kretanju vozila van oblasti usluge, odnosno u slučajevima zloupotrebe tehničkog mehanizma delokrugom procesa rada u javnoj higijeni;
- On takođe obavlja druge zadatke na zahtev direktnog lidera.

Potrebne su veštine: (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Odlčno profesionalno znanje iz relevantne oblasti; Poželjno znanje engleskog jezika;
- Poznavanje dobrih veština rada na računaru pomoću aplita programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.) i Interneta;
- Istraživanje, analitičko, vrednovanje i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Univerzitetska diploma;
- Dve (2) godine profesionalnog iskustva;

Konkurs je objavljen 15 februara 2024 godine, a zatvoren je 29 februara 2024 godine.

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

- Dokaz o školskim kvalifikacijama;
- Dokaz o radnom iskustvu (*dokaz o zaposlenju ili ugovoru*);
- Dve (*ako imate*) preporuke.
- Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o proceni rada (*ako takvi postoje*);
- Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
- Potvrde od suda da niste pod istragom.

REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj kovrti u arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Udhëheqës i Burimeve Njerëzore – 1 pozitë

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek: Sekretari i Ndërmarrjes

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Udhëheqë punën e gjithëmbarshme të Shërblimit Juridik dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Menaxhon stafin e shërbimit juridik dhe detyrat tek vartësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit juridik;
- Këshillon dhe mbështetë udhëheqësit e njësive organizative të kompanisë lidhur me përshkrimet e vendeve të punës;
- Bën vlerësim të rregullt të stafit në mbikëqyrje të tij dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave në nivel me standaret e kërkuara, si dhe punë tjera sipas urdhrave të Sekretarit Koordinator;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Shkathësitë e kërkuara: (afitësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga juridik dhe administratës publike; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;

- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathësi për shqyrtimin e lëndëve dhe të gjitha shkrimeve të nevojshme për kompaninë;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë Universitare;
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale;

Konkursi është publikuar më datë 15 shkurt 2024 dhe mbyllet më datë 29 shkurt 2024.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
3. Dy rekomandime (*nëse keni*);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
5. Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJSËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Prema članu 8. Zakona br. 03/L-212 rada, član 4 Upravnog uputstva br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A u Prištini, objavljuje ovo:

KONKURS

Naslov pozicije: Menadžer ljudskih resursa – 1 pozicija

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" SH.A – Priština

Naslov supervizora: Izveštaj sekretaru društva

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje zakazane obaveze: neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti : (kratak opis glavnih zadataka)

- Vodi ukupan rad Pravnog službe i pomaže supervizoru u postavljanju ciljeva i izradi plana za ispunjavanje ovih ciljeva;
- Upravlja pravnim osobljem i zadacima svojih podređenih, daje smernice i prati rad pravnog osoblja;
- Savetuje i podržava lidere organizacionih jedinica kompanije o opisima radnih mesta;
- Pravi redovnu procenu osoblja u nadzoru i podržava njihov razvoj kroz obuku kako bi se obezbedilo izvođenje obaveza na nivou traženih samostalnih radnika, kao i drugi rad po nalogu sekretara Korporacije;
- On takođe obavlja druge zadatke na zahtev direktnog lidera.

Potrebne su veštine : (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Odlična stručna znanja iz prava i javne uprave; Poželjno znanje engleskog jezika;
- Poznavanje dobrih veština rada na računaru pomoću aplita programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.) i Interneta;
- Mogućnost pregleda predmeta i svih potrebnih radova za preduzeće;
- Istraživanje, analitičko, vrednovanje i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Univerzitetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog iskustva;

Konkurs je objavljen 15 februara 2024 godine, a zatvoren je 29 februara 2024 godine.

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Dokaz o školskim kvalifikacijama;
2. Dokaz o radnom iskustvu (*dokaz o zaposlenju ili ugovoru*);
3. Dve (*ako imate*) preporuke.
4. Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o proceni rada (*ako takvi postoje*);
5. Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
6. Potvrde od suda da niste pod istragom.

REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj kovrti u arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191

Nëntëmbëdhjetë vite pa më të dashurin tonë



Pjetrush Mark Gjoni

(1947-2005)

Vitet po kalojnë e ne po e ndjejmë mungesë tënde çdo ditë e më shumë.
Fjalët nuk mund të shprehin dhimbjen dhe mallin që kemi për Ty. Jemi krenar
që të patëm. Pushofsh në paqe!

E kujton me mall; bashkëshortja, motrat, djemtë, vajzat, nipat e mbesat.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

